

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7807  
E shtunë, 8 qershor 2024  
Çmimi 0.50

Dialogu në Bruksel,  
Këshilli i Ambasadorëve  
Shqiptarë: BE-ja të zhvillojë  
dialog të drejtë | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## IKD-ja: DRAFT KODI I SJELLJES SË DEPUTETËVE NË KUNDËRSHTIM ME KUSHTETUTËN, RREGULLOREN E KUVENDIT DHE STANDARDET E PARLAMENTEVE DEMOKRATIKE | **FAQE 4-5**



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Kodi i Sjelljes së Deputetëve", duke potencuar se Draft Kodi i Sjelljes së Deputetëve është në kundërshtim me Kushtetutën,

Rregulloren e Kuvendit dhe standardet e parlamenteve demokratike. Sipas IKD-së, Kuvendi duhet t'i përfshijë në kod vlerat dhe standardet ndërkombëtare të cilat duhet të

reflektohen në punën e përditshme të deputetëve. IKD-ja vlerëson se deputetët duhet t'i shohin parimet e Kodit të Sjelljes si aspekte pozitive dhe jodetyruese, që Draft Kodi aktual nuk e arrin

## PARTITË KOSOVARE NË MBËSHTETJE TË PARTIVE SIMOTRA NË ZGJEDHJET EVROPIANE | **F. 7**



KOMF-I:  
PËRHAPJA  
E LOJËS SË  
RREZIKSHME  
PËR FËMIJËT NË  
'TIKTOK', THIRRJE  
PËR VËMENDJE  
TË SHTUAR! | **F. 7**



## AKTUALE



**ZELENSKY: AGRESIONI RUS  
NËNKUPTON QË EVROPA S'KA PAQE | **F. 2****

**KRITIKAT E QUINT-IT PËR  
SHPRONËSIMET NË VERI, OSMANI: KA  
HAPËSIRË T'U SHPJEGOHET MË SHUMË  
PARTNERËVE TANË | **F. 3****

**DEPUTETËT E MBËSHTESIN  
PROPOZIMIN E QEVERISË GJERMANE  
PËR ZGJATJEN E MANDATIT  
TË MISIONIT TË KFOR-IT NË KOSOVË | **F. 5****

## EKONOMI



**AUV THOTË SE USHQIMET NË KOSOVË  
KONTROLLOHEN NJËJTË SI NË  
VENDET E RAJONIT DHE TË BE-së | **F. 8****

**AKP-ja KA NXJERRË NË SHITJE 47  
LOKALE E PRONA ATRAKTIVE NË DISA  
RAJONE TË KOSOVËS | **F. 8****

## SPORT



**'THE ATHLETIC': KUJDES NGA  
SHQIPËRIA, NË 'EURO 2024' ATA  
MUND TË JENË 'HIRUSHJA' | **F. 10****

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zelensky: Agresioni rus nënkupton që Evropa s'ka paqe

PARIS, 7 QERSHOR - Paqja në Evropë, që ka lulëzuar prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, është zhdukur si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, të nisur më 2022, dhe përbën kërcënim për gjithë kontinentin, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. "Ne jetojmë në kohën kur Evropa nuk është më kontinent i paqes", ka thënë Zelensky para Parlamentit të Francës në Paris më 7 qershor. Më vonë gjatë ditës, ai do të takohet me presidentin amerikan Joe Biden. "Ne jetojmë në kohën kur nazizmi po kthehet sërish, fatkeqësisht. Tani në Evropë qytetet sërish po shkatërrohen dhe fshatrat po bëhen hi. Në Evropë ende kemi kampe filtrimi, dëbime dhe urrejtja është bërë kult i ri në Rusi".

Si Biden, ashtu edhe Zelensky, janë duke marrë pjesë në përkujtimin e 80-vjetorit të së ashtuquajturës Ditës D, përgjatë së cilës shënohet zbarkimi i forcave ushtarake aleate në Normandi, që më pas ka rezultuar me mposhtje të



nazizmit.

Përgjatë një fjalimi të mbajtur më 6 qershor, Bideni ka thënë se bota e lirë është me Ukrainën dhe nuk do t'i nënshtrohet agresionit rus, duke ngritur paralele me luftën e forcave aleate për ta çliruar Evropën prej

Gjermanisë naziste.

Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja nuk do ta braktisin Ukrainën, ka thënë Bideni.

Në ceremoninë përkujtimore nuk është ftuar as presidenti rus Vladimir Putin dhe as zyrtarë të tjerë të Rusisë.

Përgjatë bisedimeve të Bidenit me Zelenskyn, tema kryesore e bisedës pritet të jetë synimi i Kievit për t'u anëtarësuar në aleancën 32-anëtarëshe, NATO. Në një intervistë të dhënë së fundmi për revistën amerikane "Time", Bideno ka thënë se nuk e

mbështet anëtarësimin e Ukrainës në NATO.

Në një intervistë të gjatë, Bideni ka thënë se "paqja duket ashtu kur të sigurohemi që Rusia, kurrë, kurrë, kurrë, kurrë nuk do të mund ta pushtojë Ukrainën. Ashtu duket paqja". Por, ai më pas ka shtuar, "kjo nuk nënkupton NATO-n, që ata të jenë pjesë e NATO-s".

"Nënkupton që të kemi një marrëveshje me ta, sikurse e kemi me vendet e tjera, ku dërgojmë armë, që ato shtete ta mbrojnë veten në të ardhmen. Mirëpo, nuk jam i përgatitur për ta mbështetur anëtarësimin e Ukrainës në NATO".

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Irlanda dhe Çekia nisin të votojnë për zgjedhjet e Parlamentit Evropian

AMSTERDAM, 7 QERSHOR - Qendrat e votimit për zgjedhjet e Parlamentit Evropian hapen të premten në Republikën Çeke dhe në Irlandë, në ditën e dytë të këtij procesi. Përgjatë katër ditëve, sa zgjasin këto zgjedhje, do të mund të votojnë 360 milionë shtetas të 27 vendeve anëtare të bllokut evropian.

Në Irlandë, partia opozitare, Sinn Fein, synon t'i shfrytëzojë këto zgjedhje për ta rritur mbështetjen para zgjedhjeve kombëtare që pritet të mbahen në vitin e ardhshëm. "Votoni për Sinn Fein të premten, si hap i parë drejt ndryshimit të qeverisjes", ka thënë liderja e



partisë, Mary Lou McDonald. Irlanda i ka 14 ulëse të

rezervuara në Parlamentin Evropian.

Publiku në këtë shtet është i shqetësuar për rritjen e numrit të azilkërkuesve, prandaj edhe është rritur numri i kandidatëve të pavarur që kanë dalë me premtimet për politika më të ashpra të imigrimit.

Në Republikën Çeke zgjedhjet do të mbahen të premten dhe të shtunën. Ky shtet i ka 21 ulëse të rezervuara në Parlamentin Evropian.

Partia opozitare ANO pritet t'u afrohet shifrave të partive që janë aktualisht në pushtet, sipas agjencisë çeke të sondazheve, STEM.

Duke qenë zgjedhjet e para pas pandemisë së koronavirusit,

nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, valës së imigrantëve dhe rritjes së rreziqeve prej ndryshimeve klimatike, këto zgjedhje po konsiderohen tejet të rëndësishme për të ardhmen e Parlamentit Evropian.

Kjo, gjithashtu, është herë e parë që mbahen zgjedhje të tilla pa Britaninë e Madhe, e cila është larguar zyrtarisht prej BE-së më 2020.

Holanda ka qenë shteti i parë që i ka nisur votimet të enjten, ndërsa të shtunën procesi nis edhe në Itali, Letoni, Maltë, Sllovaki dhe Itali.

Pjesa tjetër e shteteve do të votojnë të dielën.

## Punëtorët e Samsung-ut në Korenë e Jugut nisin grevë për herë të parë

SEUL, 7 QERSHOR - Punëtorët e gjigantit teknologjik Samsung Electronics në Korenë e Jugut e kanë nisur të premten grevën e parë ndonjëherë.

Samsung Electronics është një prej kompanive më të mëdha në botë për prodhim të telefonave të mençur dhe një prej pak kompanive në botë që prodhon çipat e nevojshëm për kryerje të shumë funksioneve teknologjike. Menaxhmeti i kompanisë

është duke negociuar me sindikatat për pagat e punëtorëve qysh prej janarit, mirëpo palët nuk kanë arritur të një zgjidhje. "Greva e parë në Samsung Electronics është duke u zhvilluar sot përmes marrjes së pushimit dhe po kuptojmë që shumë punëtorë janë duke marrë pjesë", ka thënë Son Woo-mok, udhëheqës i sindikatës së punëtorëve. Kompania ka thënë se një veprim i tillë nuk do të ketë

ndikim në prodhim dhe në aktivitete të tjera biznesore. Rreth 10 punëtorë janë parë të premten para zyrave të Samsungut në Seul duke bërë titur: Respektojeni punën. Ne nuk duam rritje 6.5 për qind apo bonus 200 për qind".

Samsung Electronics është pjesë e konglomeratit Samsung Group, që dominon sferën biznesore në Korenë e Jugut, ekonominë e katërt më të madhe në Azi.





# Partitë kosovare në mbështetje të partive simotra në zgjedhjet evropiane

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Parlamenti Evropian (PE) nuk është sikur parlamentet kombëtare por, megjithatë, duhet ta ketë një shumicë të nevojshme për të miratuar vendime. Zgjedhjet për këtë institucion me seli në Strasburg nisën më 6 qershor dhe do të mbarojnë më 9 qershor. Ato zhvillohen në të 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Shumica në PE që do të formohet pas tyre, do ta konfirmojë presidentin apo presidenten e Komisionit Evropian. Pastaj, për secilin komisionar veç e veç, do të duhet të organizohet seanca dëgjimore ku do t'i jepet besimi.

Grupet politike në Parlamentin Evropian formohen sipas ideologjisë së prioriteteve që i kanë. Ato reflektojnë, pak a shumë, qëndrimet e partive nacionale në një familje të përbashkët politike në nivel evropian.

Pos grupeve politike në PE, ekzistojnë edhe partitë politike në nivel të BE-së që, po ashtu, bashkohen me programet e tyre. Edhe tri partitë më të mëdha nga Kosova janë të angazhuara në mënyra të ndryshme - sipas statuteve të tyre - me partitë e orientimit të njëjtë evropian.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, është afruar me Partinë Socialiste Evropiane - parti e qendrës së majtë që në Parlamentin Evropian përfaqësohet nga grupi Socialistët dhe Demokratët (S&D).

Ky ishte grupi i dytë më i madh



në përbërjen e deritashme të PE-së - me 139 deputetë.

Në grupimin më të madh politik në Parlamentin Evropian, që është Partia Popullore Evropiane (PPE) - anëtare e asocuar është prej vitesh Lidhja Demokratike e Kosovës.

PPE kishte 176 deputetë në përbërjen e deritashme të PE-së. Partia Demokratike e Kosovës, ndërkaq, është anëtare e grupit liberal evropian, ALDE, i cili në PE përfaqësohet nga grupi Renew.

Në përbërjen e deritashme të PE-së, ky ishte grupimi i tretë më i madh me 102 deputetë.

Mbështetja e partive dhe liderëve politikë nga një vend për partitë politike në vendet e tjera në zgjedhje nuk shihet si ndërhyrje

në punët e brendshme.

Ky solidaritet partiak konsiderohet legjitim, por nuk duhet të përzihet me institucionet shtetërore.

Kur kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në takimin e Partisë Socialiste Evropiane në Berlin bëri ftesë që të votohet për kandidatët e këtij grupi në zgjedhjet evropiane, ai e bëri këtë jo si kryeministër, por si lider i partisë, pra Lëvizjes Vetëvendosje, që është pjesë e asaj familjeje. "Ishim në Berlin, në konferencën e nivelit të lartë të Partisë së Socialistëve Evropianë, ku, përkrah edhe kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, shprehëm mbështetjen për kandidatët socialdemokratë, Katarina Barley dhe Nicolas

Schmit", shkroi Kurti në rrjetet sociale pas kësaj konference. "Vota për ta është e domosdoshme për mbrojtjen e vlerave e parimeve demokratike, të solidaritetit e të gjithë përfshirjes, të të drejtave të njeriut e sundimit të ligjit, të drejtësisë sociale e të pluralizmit politik. Këto janë të kërcënuara çdo ditë e më shumë nga rrymat e djathta radikale që tentojnë të na rikthejnë në periudhat e zymta dhe të errëta të shekullit të kaluar, por edhe nga parti të djathta që në vend se të distancohen, koketojnë me to", tha Kurti.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, u përfshi në fushatën për zgjedhjet evropiane nëpër vendet e BE-së,

kryesisht në Gjermani dhe Austri, ku kërkoi nga diaspora e Kosovës t'i votojë kandidatët e PPE-së. Ai tha se fitorja e qendrës së djathtë në zgjedhjet evropiane do të krijojë siguri edhe për Kosovën.

Aktivë ishin edhe disa anëtarë të PDK-së, duke marrë pjesë në takimet e liberalëve evropianë.

Angazhimi i politikanëve nga Kosova në fushatën zgjedhore për zgjedhjet evropiane shihet si i rëndësishëm edhe për shkak të rritjes së numrit të shqiptarëve nga vende të ndryshme në vendet e Bashkimit Evropian.

Vota e tyre në disa raste, madje, mund të jetë vendimtare.

Partitë politike të Kosovës, sikur edhe ato nga vendet e tjera të rajonit, i shfrytëzojnë lidhjet me partitë e orientimit të njëjtë në Evropë edhe për mbrojtjen e interesave të vendeve të tyre.

Kjo ka ndihmuar që në Parlamentin Evropian, që nga përfundimi i luftës në Kosovë më 1999, të ketë mbështetje të madhe për të si për liberalizimin e vizave, dialogun me Serbinë apo njohjen e pavarësisë së Kosovës nga pesë vendet mosnjohëse të BE-së: Greqia, Spanja, Rumania, Qiproja dhe Sllovakia.

Në Parlamentin Evropian rezolutat dhe raportet miratohen me shumicën e votave, andaj ky institucion i BE-së ka mundur të jetë më i favorshëm ndaj Kosovës sesa që është Këshilli i BE-së. Në këtë të fundit, për çështje të jashtme dhe të zgjerimit, vendoset me konsensus të të gjitha vendeve anëtare.

## Kritikat e Quint-it për shpronësimet në veri, Osmani: Ka hapësirë që t'u shpjegohet më shumë partnerëve tanë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka folur lidhur me shpronësimet në veri të vendit, për të cilat një ditë më parë reagoi edhe Quint-i, ku theksohet se qeveria ka shkelur ligjet dhe rregulloret e veta për shkak të mangësive procedurale dhe teknike gjatë procesit të shpronësimit.

Osmani në një deklaratë për medie, pas vizitës në komunën e Drenasit, tha se çështja e shpronësimeve ka rregulla të caktuara dhe këto rregulla jo vetëm që përcaktohen me ligje tona, por edhe me standardet evropiane të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. "Çështja e shpronësimeve ka rregulla të caktuara dhe këto rregulla jo vetëm që përcaktohen me ligje tona, por edhe me standardet evropiane të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për aq sa respektohen këto standarde



është një test pesë hapësh i paraparë nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përderisa respektohet

ky standard dhe të gjithë pesë hapat janë aplikuar kjo tregon se është zbatuar edhe ligji ynë edhe kërkesat tona kushtetuese dhe

standardet evropiane të të drejtave të njeriut dhe shpronësimet vazhdojnë në përputhje me ligjin pa asnjë

tendencë për diskriminim të askujt", ka theksuar ajo.

Sipas saj, është e domosdoshme për sigurinë e të gjithëve që veriu i Kosovës të mbrohet nga sulmet e Serbisë dhe në mënyrë që Kosova të mbrohet ka nevojë për prani të institucioneve tona të sigurisë. "Prandaj, përderisa shpronësimet janë në përputhje të plotë me ligjet, Kushtetutën dhe pesë hapat që janë standard i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si presidente ndoshta ka ende hapësirë për komunikim që të shpjegohen këto çështje në detaje nga institucionet përgjegjëse tek partnerët tanë...", ka thënë Osmani.

E para e shtetit tha se nuk sheh asnjë tendencë për diskriminim të askujt. Presidentja tha tutje se e kanë për të detyrë ta mbrojnë çdo qytetar të Kosovës pa dallim etnie dhe të mbrojnë çdo cep të Kosovës.



## IKD-ja: Draft Kodi i sjelljes së deputetëve, në kundërshtim me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet e parlamenteve demokratike

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin “Kodi i Sjelljes së Deputetëve”, duke potencuar se Draft Kodi i Sjelljes së Deputetëve është në kundërshtim me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet e parlamenteve demokratike. Sipas IKD-së, Kuvendi duhet të përfshijë në kod vlerat dhe standardet ndërkombëtare të cilat duhet të reflektohen në punën e përditshme të deputetëve. IKD-ja vlerëson se deputetët duhet t’i shohin parimet e Kodit të Sjelljes si aspekte pozitive dhe jodetyruese, gjë që Draft Kodi aktual nuk e arrin

i Kuvendit dhe deputetët që një kod të tillë ta tërheqin nga miratimi prej seancës së ardhshme plenare, t’i bëjnë ndryshimet në përputhje me komentet e IKD-së dhe më pastaj ta sjellin për miratim.

Aspektet kryesore problematike të Draft Kodit të Sjelljes së Deputetëve janë: Kodet e Sjelljes së deputetëve kanë për qëllim krijimin e kulturës politike duke pasur parasysh korrektësinë, transparencën dhe ndershmërinë. Draft Kodi i propozuar nga Komisioni për Legjislacion nuk arrin ta vendosë vullnetin dhe veprimet politike për arritjen dhe ngritjen e standardeve etike. Ai përqendrohet në mënyrë ekskluzive të rregullimi i sjelljes së deputetëve përmes sanksioneve përjashtuese dhe financiare të cilat përbëjnë dobësim të demokracisë përfaqësuese dhe se kufizimet që janë vendosur përmes këtij kodi reflektohen me cenim të përfaqësimit të qytetarëve përmes deputetëve që qytetarët kanë zgjedhur.

Përjashtimi i deputetëve nga tri (3) seancat e ardhshme plenare është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit sepse, sipas saj, deputeti mund të largohet nga seanca në të cilën ai kryen shkelje, por jo edhe në

seancat e radhës, siç është në rastin konkret në Draft Kod, deri në tri (3) seanca.

Sanksioni disiplinor i tillë është tejkalim i aktit përmes të cilit Kuvendi merr të drejtën për ta miratuar Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Pasoja e përjashtimit duhet të vlejë vetëm në rastet kur veprimi joparlamentar i deputetit ndodh aty për aty dhe përjashtohet nga ajo seancë dhe jo nga seancat e ardhshme. Përtej kësaj, duhet theksuar se suspendimi/përjashtimi nga seancat e radhës të deputetit mund të rezultojë në abuzim nga shumica parlamentare për t’i larguar deputetët e opozitës parlamentare dhe për ta deformuar shumicën natyrore. Kështu, një dispozitë e tillë mund të sjellë deri te përdorimi i tepruar i masës së përjashtimit në shumë seanca të cilat realisht do të ndikojnë në balancimin ndërmjet shumicës parlamentare dhe opozitës. Në anën tjetër, aplikimi i tillë i kësaj dispozite do të cenojë të drejtën e deputetit për t’i përfaqësuar qytetarët dhe të drejtën e tij kushtetuese për të marrë pjesë në procesin e votimit. Në rastin konkret, e drejta e deputetit si individ mbetet e nivelit të dytë, përballë së drejtës së qytetarëve që në Kuvend të përfaqësohen

me deputetin/en që ata kanë votuar.

Dënimet financiare të parashikuara në këtë kod tejkalojnë sanksionet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, e cila lejon sanksione deri në nivelin e shumës që është e barabartë me kompensimin për një seancë plenare, por jo deri në 50 % të pagës bazë. Kjo është në kundërshtim me Rregulloren dhe lë Këshillin e Etikës me diskrecion të madh, që mund të çojë në arbitraritet. Dënimet financiare mund të mos jenë pengesë efektive për deputetët e pasur ose ata me të ardhura të konsiderueshme jashtë Kuvendit, dhe mund të shihet si çmimi i një veprimi politik. Përqendrimi në dënimet financiare zhvendos fokusin nga parimet e sjelljes së mirë dhe shërbimit publik në një sistem ndëshkimi thjesht monetar.

Kuvendi duhet të përfshijë në kod vlerat dhe standardet ndërkombëtare të cilat duhet të reflektohen në punën e përditshme të deputetëve. Deputetët duhet t’i shohin parimet e Kodit të Sjelljes si aspekte pozitive dhe jodetyruese, gjë që Draft Kodi aktual nuk e arrin. Një nga qëllimet e kodit duhet të jetë inkurajimi dhe mirëkuptimi

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 7 QERSHOR** - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin “Kodi i Sjelljes së Deputetëve”, duke analizuar përputhshmërinë me parimet kushtetuese, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet e parlamenteve demokratike.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës miratimin e Kodit të Sjelljes për Deputetët.

Ky kod synon të vendosë parime, t’i përcaktojë sjelljet e papranueshme, t’i përshkruajë masat ndëshkuese dhe të formojë një Këshill të Etikës për zbatimin e këtij kodi.

Edhe pse pati kohë të mjaftueshme prej një viti e nëntë muaj, për ta hartuar një kod në pajtim me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet ndërkombëtare, Komisioni për Legjislacion nuk arriti të hartojë dhe të dërgojë në seancë plenare një Draft të Kodit të Sjelljes në pajtim me këto dokumente.

Draft Kodi aktual përmban disa çështje të cilat minojnë efektivitetin dhe përafrimin e tij me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet e parlamenteve demokratike.

Për këto arsye Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e ka parë të nevojshme publikimin e një dokumenti të tillë, në mënyrë që t’u ndihmojë deputetëve të kenë një qëndrim të mirinformuar sa i përket këtij Draft Kodi, për të cilin IKD-ja kërkon nga kryetari



## Deputetët e mbështesin propozimin e qeverisë gjermane për zgjatjen e mandatit të misionit të KFOR-it në Kosovë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Misioni i ushtrisë gjermane në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë duhet të vazhdojë. Me rëndësi gjendja në Kosovë dhe B-H. Shumica e përfaqësuesve në parlamentin gjerman, Bundestag, janë pro vazhdimin të dy misioneve të Bundeswehrit në Ballkan. Përveç koalicionit në pushtet të tri partive (SPD, të Gjelbërit dhe Liberalëve), partitë opozitare kristiandemokrate CDU dhe CSU gjithashtu i dhanë mbështetje propozimit të qeverisë gjermane për zgjatjen e mandatit të misionit të KFOR-it në Kosovë të mërkurën (5 qershor) në leximin e parë. "Na duhet KFOR-i i aftë për veprim për ta reduktuar potencialin e vazhdueshëm për konflikte dhe përshkallëzim në veri të Kosovës dhe në kufirin me Serbinë", tha përfaqësuesi i demokristianëve në Bundestag, përgjegjës për politikën e mbrojtjes, Florian Hahn (CSU). Vazhdimi i pjesëmarrjes së Gjermanisë në misionin e BE-së EUFOR Althea në Bosnjë-

Hercegovinë u miratua edhe nga përfaqësues të Alternativës për Gjermaninë (AfD).

Vendimi përfundimtar për propozimin e qeverisë gjermane për zgjatjen e të dy mandateve duhet të merret javën e ardhshme. "Ballkani Perëndimor është fqinjësia jonë e afërt. Prandaj, ruajtja e paqes në këtë rajon është përgjegjësia jonë", theksoi sekretarja e Shtetit për Mbrojtje, Siemtje Möller (SPD).

Në propozimin e qeverisë thuhet se bazë për misionin e KFOR-it "është ende Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara" dhe thekson se "si Kosova ashtu edhe Serbia e kanë bërë gjithmonë të qartë se duan vazhdimin e pranisë së KFOR-it".

Misioni i NATO-s në Kosovë, i cili po vazhdon prej 25 vitesh, është angazhim i më i gjatë i ushtrisë gjermane (Bundeswehr) jashtë vendit. Numri maksimal i pjesëtarëve të njëjësive gjermane të veprimit



të shpejtë do të mbetet në 400. Forcat ndërkombëtare të KFOR-it synojnë ta sigurojnë vendosjen e paqes dhe rendit publik në Kosovë. Megjithatë, kohët e fundit tensionet me

Serbinë fqinje janë rritur sërish. Misioni Althea i Bashkimit Evropian, në të cilin Bundeswehr po merr pjesë deri me 50 ushtarë, synon ta sigurojë përputhjen me

Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit që i dha fund luftës në Bosnjë-Hercegovinë më 1995. Dhe ky vend, sipas Berlinit, konsiderohet ende një burim i mundshëm konflikti. (dw)

## Dialogu në Bruksel, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: BE-ja të zhvillojë dialog të drejtë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë thekson se Bashkimi Evropian duhet të fokusohet në lehtësimin e një dialogu të drejtë e që respekton pavarësinë e Kosovës, ndërsa bën thirrje që të caktohet negociatori nga rangu i diplomatëve/politikanëve të mirëpritur dhe të pranuar nga të dyja vendet, në mënyrë që të rritet niveli i besueshmërisë të të gjitha palët.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë (KASH) thekson se ka ndjekur me shumë interes dhe shqetësim negociatat e stërzgatura ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe dëshiron të



shohë një marrëveshje përfundimtare sa më shpejt të jetë e mundur. "Këshilli i

Ambasadorëve qëndron kundër presionit ndaj Kosovës që të pajtohet me formimin e

Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe beson se një presion i tillë minon sovranitetin e Kosovës dhe inkurajon qëndrimin e Serbisë për mosnjohje. Zgjidhjet e imponuara mund ta destabilizojnë rajonin", thuhet tutje në reagim.

KASH thekson se kontributi dhe roli i pazëvendësueshëm i BE-së duhet të fokusohet në lehtësimin e një dialogu të drejtë që respekton pavarësinë e Kosovës. Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i bën thirrje BE-së, po ashtu, që për dialogun Kosovë - Serbi të caktojë negociator nga rangu i

diplomatëve/politikanëve të mirëpritur dhe të pranuar nga të dyja vendet, në mënyrë që të rritet niveli i besueshmërisë tek të gjitha palët.

KASH, kërkon, gjithashtu, që sjelljet e Serbisë si përfaqësuese ruse dhe retorika e liderit të Republika "Srpska", Milorad Dodik, për ndarjen nga Bosnja dhe Hercegovina, të ndalet me çdo kusht përpara se të jetë tepër vonë. "Ne e konsiderojmë këtë si një instrument lufte, si një qasje që shkon në të njëjtën linjë/logjikë me agresionin rus kundër Ukrainës", thuhet tutje në reagimin e Këshillit të Ambasadorëve.

për mënyrën se si deputetët zbatojnë parimet dhe standardet që ata miratojnë, duke reflektuar mbi to dhe duke u sjellë sipas tyre.

Njohuria e deputetit mbi kodin konsiderohet që nga momenti i betimit si deputet, por ky rregullim është problematik sepse nuk përcakton se kush ua dorëzon kodin deputetëve dhe lidhja që i bëhet betimit dhe njohurive mbi kodin është problematike sepse nuk mund të bëhet kjo çështje kështu. Draft Kodi duhet të parashikojë saktësisht kush e dorëzon Kodin e Sjelljes dhe të kërkojë një deklaratë të nënshkruar nga deputeti që konfirmon pranimin dhe zbatimin e parimeve të kodit gjatë punës së tij.

Draft Kodi nuk parashikon mjetin juridik të ankesës ndaj vendimeve të Këshillit të Etikës, kjo në kundërshtim me Nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës, që garanton të drejtën për mjet juridik. Mungesa e një dispozite ku parashihet mjeti juridik, është kundër konceptit themelor juridik për të drejtën e ankesës dhe standardeve parlamentare demokratike. Komisioni për Legjislacion duhet ta kthejë Draftin e Kodit dhe ta sigurojë përfshirjen e të drejtës për ankesë dhe përcaktimin e organit kompetent për shqyrtimin e ankesave.

Draft Kodi i propozuar nuk u lejon deputetëve ta kundërshtojnë vendimin e shumicës në Këshill të Etikës

ose të japin mendime konkurruese kur pajtohen me votimin, por jo me arsyetimin e dhënë. Komisioni duhet t'i parashikojë mendimet mospajtuuese dhe konkurruese për të ofruar argumente të qarta dhe të mbështetura mirë, duke sfiduar vendimet e shumicës dhe duke rritur thellësinë e analizës ligjore. Kjo do të kontribuojë në interpretimet dinamike të Kodit të Sjelljes.

Në kod janë përfshirë në mënyrë të panevojshme dispozita të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë, dhuratave dhe konfliktit të interesit. Kjo bartje dispozitash tregon për një nivel të ulët serioziteti nga hartuesi. Kodet duhet të

përcaktojnë standarde të sjelljes dhe jo detaje të stërholluara, veçanërisht kur këto dispozita janë tashmë të përfshira në ligje ekzistuese. Komisioni për Legjislacion ka vendosur dispozitën përmes së cilës përfaqësimi në Këshillin e Etikës të bëhet sipas rezultatit të zgjedhjeve parlamentare. Kjo përbërje presupozon që vendimet do të varen nga shumica parlamentare. Këshilli i Etikës nuk duhet ta përdorë fuqinë politike për shkeljet e Kodit të Etikës, por të bazohet në dëshmitë e shkeljeve, duke vendosur me konsensus të plotë.

IKD propozon që përbërja e KE-së të jetë e barabartë ndërmjet shumicës dhe opozitës, të përfshijë ish-

gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe kryesimi të bëhet nga opozita ose me rotacion.

Draft Kodi dështon të përfshijë dispozita për hartimin dhe miratimin e raportit vjetor të punës, gjë që cenon transparencën dhe llogaridhënien e Këshillit të Etikës. Kjo pamundëson planifikimin dhe priorizimin e aktiviteteve të ardhshme dhe matjen e efektivitetit të punës së tyre.

Duke i adresuar këto rekomandime, Kuvendi i Kosovës mund të miratojë një Kod Sjelljeje më efektiv dhe pa të meta kushtetuese e ligjore dhe që rritë standardet etike pa cenuar përfaqësimin demokratik.



## LDK-ja konferencë ndërkombëtare "Rugova dhe Perëndimi", marrin pjesë kryeministri Edi Rama dhe personalitete të tjera

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Fondacioni "Ibrahim Rugova" të hënën, më 10 qershor, nga ora 11:00, do ta mbajnë konferencën ndërkombëtare "Rugova dhe Perëndimi", në shënim të 25-vjetorit të lirisë së Kosovës. Në njoftim thuhet se konferenca mbahet në nderim të trashëgimisë

politike të presidentit Rugova, sikurse dhe në nderim të aleatëve që patën rol thelbësor në orët tona më të rënda. "Konfirmimi i orientimit euroatlantik të Kosovës, si besim vleror i popullit të Kosovës, trashëgimi politike e Ibrahim Rugovës, mbetet qëllimi kryesor i Konferencës", thuhet tutje.

Në panel do të jenë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ish-kryeministri i Italisë, Massimo D'Alema, Vincenzo Pagli, president i Akademisë Papnore për Jetën dhe Jeffrey M. Hovenier, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë. Në panelin e dytë do të jenë gazetarë dhe shkrimtarë.



## 140 mijë vetura hyjnë në Prishtinë brenda ditës, Rama thotë se kanë bërë zgjidhjen përfundimtare për problemin e trafikut



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se trafiku i mbingarkuar ka qenë për një kohë të gjatë problematikë me të cilën është përballur kryeqyteti. "Një telash i madh, të cilin nuk mund ta linim pa i dhënë zgjidhje. Fillimisht na duhej të dinim sa makina hyjnë e dalin dhe sa qarkullojnë rrugëve të Prishtinës. Kemi vendosur 18 kamera në rrugët dhe udhëkryqet kryesore të qytetit.

Dhe për dy javë rresht e kemi matur trafikun përgjatë 24 orëve. Tani e dimë që 140 mijë makina hyjnë brenda ditës në qytet. Prej tyre, 13 mijë vetëm gjatë orës kulmore, nga të cilat 9 mijë qarkullojnë vetëm në unazën e brendshme. Për pasojë, pritjet mesatare në semaforë kanë dalë të jenë 298 sekonda për automjet. Pra, mijëra euro humbje ditore në karburant. Dhe dhjetëra e qindra mijëra të tjera në orë pune. Krejt këto i takojnë së

shkuarës", ka thënë Rama. Ai ka shtuar se zgjidhja e problemit të trafikut nga SHAK-u dhe kryeqyteti bën të mundur që pritja në semafor të zvogëlohet për 95 %, shpenzimet e karburantit për 80 % dhe që shpejtësia mesatare e lëvizjes të rritet nga 12 km/h sa ishte, në 37 km/h. "Pra, një qark i plotë në unazën e brendshme të qytetit, e cila paraprakisht zgjaste 55 minuta, tani kryhet për 12 minuta", ka thënë Rama.

## Kamenica, nikoqire e ekspertëve nga Belfasti i Irlandës Veriore

KAMENICË, 7 QERSHOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka njoftuar se për tri ditë radhazi, ekspertët dr. Edona Maloku, prof. Joanne Hughes, prof. Tony Gallagher, prof. Ruth Leitch, dr. Gavin Duffy, Paul Close dhe Seamus Bradley, kanë ndarë me kolektivet e shkollave të komunës së Kamenicës, duke përfshirë edhe drejtorët dhe mësuesit e shkollave serbe, praktikat më të mira për hartimin e modelit të arsimit të përbashkët, model ky që vjen nga Irlanda Veriore. "Arsimi i përbashkët (Shared Education) si koncept ka për qëllim afrimin dhe krijimin e relatave të ndërsjella dhe

ndërveprimit mes fëmijëve të grupeve të ndryshme nëpërmjet kontaktit dhe ndërveprimit konsistent që është i përcaktuar me këtë model", ka thënë kryetari Rahimaj. Ai ka shtuar se profesorët e Queen's University janë takuar edhe nga kryeministri Albin Kurti në një drekë pune i cili ka përshëndetur kontributin e tyre si dhe vullnetin e treguar për t'i ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre në raport me fushën e arsimit. I pranishëm në këtë drekë të përbashkët pune ka qenë edhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves.



## Kurti priti në takim ekipin përfaqësues të Kosovës në Bienalen e Venedikut



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministria e Kulturës, Daulina Osmani, këshilltarët politike në MKRS, Nora Arapi-Krasniqi dhe Rozafa Imami, kanë pritur në takim ekipin përfaqësues të Kosovës në Bienalen e Venedikut, i përbërë nga artistja Doruntina Kastrati, kuratore Erëmira Krasniqi dhe

komisionere Hana Halilaj. Kosova në edicionin e 60 të Bienales së Artit të Venedikut po përfaqësohet me instilacionin "Heshtjet Kumbuese të Metalit dhe Lëkurës" që ka për fokus gratë në ekonominë e periudhës së tranzicionit dhe trajton punën e feminizuar, pabarazitë në vendin e punës dhe pasojat e tyre në një

fabrikë llokumesh në Prizren duke i kushtuar vëmendje dhimbjes dhe sakrificës së tyre. Në mesin e 86 pavijoneve shtetërore garues këtë vit, Kosova është vendi i vetëm nga Evropa që mori Mirënjohje të Veçantë për Përfaqësim Shtetëror, për të cilën kryeministri Kurti i përgëzoi.



## Një muaj paraburgim për dy të dyshuarit për spiunazh

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ua ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji dy burrave të cilët u arrestuan një ditë më parë nën dyshimin për spiunazh.

Në një njoftim për medie të enjten vonë, gjykata tha se gjyqtari e pranoi si të bazuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurve B. Sh. dhe M. Q., të dyshuar për spiunazh. "Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet për caktimin e paraburgimit, pasi nëse të pandehurit lihen në liri, mund të jenë të paarrtshëm për procedurën penale dhe ka rrezik të ikjes. Po ashtu, gjykata vlerësoi se, nëse të pandehurit

do të jenë në liri, mund të asgjësojnë, fshehin, ndryshojnë ose falsifikojnë provat e veprave penale, ose do ta pengojnë rrjedhën e procedurës penale", thuhet në njoftim.

Prokuroria e Kosovës bëri me dije më 5 qershor se dy shtetasit kosovarë u arrestuan pas një hetimi disamujor dhe se i ngarkon ata me veprën penale "spiunazh".

Ndërkohë Policia e Kosovës ka konfiskuar armë, municione dhe maska ushtarake gazi në dy lokacionet e ku u arrestuan këta dy të dyshuar në Ferizaj.

Gjykata Themelore tha të enjten se ndaj të pandehurit M. Q. e caktoi masën prej një muaji paraburgim edhe për shkak të



një veprë të dytë penale me të cilën ngarkohet ai, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të

paaautorizuar të armëve. Ajo tha se palët kanë të drejtë të ankohen kundër aktvendimit të

gjykatës.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë dhënë hollësi për këtë rast. Por, mediet lokale raportuan se personat e ndaluar dyshohet se kanë spiunuar për Agjencinë Serbe të Sigurisë dhe Informacionit (BIA).

Në një reagim të mërkurën, BIA-ja tha se e mohon "çdo lidhje me personat e arrestuar në Kosovë". BIA-ja shtoi se bëhet fjalë për "përpjekjet e Prishtinës për përhapjen e lajmeve të rreme, se janë dy persona me initiale B. Sh. dhe M. Q. të cilët janë arrestuar të mërkurën në Ferizaj me akuzën se kanë kryer veprë penale të spiunazhit në marrëdhënie bashkëpunimi me Agjencinë".

## KOMF-i: Përhapja e lojës së rrezikshme për fëmijët në 'TikTok', thirrje për vëmendje të shtuar!

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), i cili përfaqëson 34 organizata joqeveritare, ka ndjekur me shumë shqetësim informatat e publikuara në medie mbi përhapjen e lojës së rrezikshme që po qarkullon në "TikTok" "Sfidë apo e vërtetë", e cila nxit sjelljet vetëdëmtuese të fëmijëve. Deri tani, sipas publikimeve në dy shkolla 9-vjeçare të komunës së Fushë-Kosovës dhe Lipjanit, janë identifikuar rreth 20 nxënës të cilët kanë marrë pjesë në këtë lojë duke dëmtuar krahët e tyre me mjete të mprehta. Megjithatë, ekziston mundësia që ky numër të jetë më i madh apo që ai të rritet në ditët në vijim, duke qenë se loja qarkullon online dhe është e qasshme në telefona, pajisje të cilën shumë fëmijë e posedojnë apo me të cilën ata kalojnë një kohë të gjatë.

U drejtohem të gjithë fëmijëve, kjo nuk është një "lojë". Luajtja e kësaj loje ju dëmton fizikisht dhe



mund të ketë pasoja që zgjasin në shëndetin tuaj. Përfshihuni në lojëra që ju ndihmojnë të rriteni të

fortë e të shëndetshëm dhe qëndroni larg këtyre mashtrimeve. KOMF u bënë thirrje të gjithë

fëmijëve që të raportojnë te prindi apo mësuesi, nëse kanë informacion se shokët apo shoqet

e tyre janë të përfshirë në këtë lojë. Vetëm kështu mund të ndihmoni vërtet shokët tuaj!

KOMF u bënë thirrje të gjithë prindërve t'i monitorojnë fëmijët gjatë qëndrimit të tyre në internet dhe të flasim me fëmijët për këtë "lojë", rreziqet dhe dëmet që ajo sjell.

KOMF u bënë thirrje prindërve, mësuesve dhe institucioneve të mandatuara, të kenë vëmendje dhe kujdes të shtuar për të parandaluar raste të reja të fëmijëve që mund të manipulohen nga kjo lojë. Po ashtu, kërkon të sigurohet komunikim dhe koordinim intensiv dhe i vazhdueshëm mes palëve të sipërpërmendura, në mënyrë që çdo rast i ri të referohet në kohë për t'i marrë shërbimet dhe ndihmën e nevojshme.

KOMF, po ashtu, u bënë thirrje institucioneve ta zbatojnë me përpikëri udhëzimin administrativ (QRK) nr. 04/2022 për masat për mbrojtjen e fëmijës kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës, i cili derivon nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës.

## Ngrihet aktakuzë kundër 23 të pandehurve për rastin 'Call Center', dyshohet se mashtruan shtetasit gjermanë

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë kundër 23 të pandehurve për rastin e 'Call Center'. Sipas një njoftimi, bëhet me dije se inicialet e të pandehurve janë: A. E, K. G., I. L., D. H., M. T., V. K., A. Z., L. H., Ç. Q., F. H., M. K., F. K., I. S., S. P., A. V., A. N., I. XH., A. Dh., E. L., A. M., K. R., E. R., Q. I. Më tutje thuhet se, sipas aktakuzës, të pandehurit dyshohet se kanë kryer vepra penale gjatë viteve

2019 -2021 me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material, ku si pasojë janë mashtruar qytetarët - shtetas gjermanë, përmes qendrave të thirrjes 'Call Center', duke investuar nëpër platforma online. "Me veprimet e lartcekura të pandehurit dyshohet se kanë kryer veprat penale: 'Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar' nga neni 277 lidhur me veprën penale 'Mashtrim' nga neni 323, par. 4, lidhur me par. 1 të KPRK-së, 'Shpëlarja e parave' nga neni 302

i KPRK-së dhe neni 56 dhe 57 të Ligjit 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit dhe 'Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale' nga neni 380, par. 3, lidhur me par. 1, dhe me neni 31 të KPRK-së", thuhet në njoftim.

Ndërkaq, në njoftim bëhet me dije se ky rast është hetuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës së bashku me autoritetet gjermane, saktësisht me Prokurorinë Publike në Bamberg - Gjermani.





## AUV thotë se ushqimet në Kosovë kontrollohen njëjtë si në vendet e rajonit dhe të BE-së

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Në Ditën Botërore të Sigurisë së Ushqimit nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) thonë se ushqimet në Kosovë kontrollohen njëjtë si në shtetet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, derisa bëjnë thirrje t'i kushtohet rëndësi sigurisë së ushqimit.

Lamir Thaçi, zëdhënës i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në një intervistë për Telegrafin ka thënë se për sot kanë parë aktivitete që të japin sa më shumë informata për qytetarët mbi rëndësinë që ka siguria ushqimore. “Ne sot kemi paraparë të japim sa më shumë informata për qytetarët, përmes juve medieve që sensibilizojnë mbi rëndësinë që ka siguria ushqimore për shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Secili kudo që është në kontakt me ushqimin të ushtrojë kujdes, sepse në këtë formë kujdeset, në radhë të parë për vetveten dhe për të gjithë ata që do ta konsumojnë ushqimin që ai ka qenë në kontakt, përveç neve që kemi përgjegjësi për kontroll

gjatë gjithë kohës”, u shpreh ai. Më tutje, ai shtoi se “të gjithë mund të kontribuojnë që të kemi ushqime sa më të sigurta, sa më cilësore, që ne qytetarët, konsumatorët të kenë shëndet më të mirë dhe të rritet jetëgjatësia e qytetarëve”.

Gjatë intervistës ai shtoi se ushqimet në vendin tonë kontrollohen sikurse në vendet e rajonit dhe të BE-së. “Ushqimet në Kosovë mund të themi se janë të kontrolluara njëjtë sikurse në shtetet e rajonit dhe në Bashkimin Evropian, sepse kemi procedura të njëjtë të kontrollit; kemi rregullore dhe ligje mbi bazën e të cilëve ushtrojmë detyrat në punë dhe këto kontrollohen në nivele të njëjta të kontrollit. Pra, kontrollet bazohen në planet nacionale të kontrolleve, të cilat parashohin edhe frekuencën apo shpeshtësinë e kontrolleve që ushtrohen te bizneset, kjo pastaj varet edhe nga numri i kapacitetit të inspektorëve që kemi aktivë në terren”, ka thënë ai.

Në intervistë, Thaçi bëri me dije se



mundohen që të gjitha produktet që dalin në treg të jenë të kontrolluara, pavarësisht numrit të vogël të inspektorëve që kanë. Gjithashtu, ai tha se mbështetjen edhe nga inspektorët sanitarë të Ministrisë së Shëndetësisë derisa

tha që shpreson që sa më shpejt t'i marrin inspektorët e sigurisë ushqimore dhe të plotësohen mungesat.

Siguria e ushqimit dhe të ushqyerit e drejtë janë parakushte themelore për shëndet dhe


mirëqenie të popullatës së një vendi.

Më 20 dhjetor 2018 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 73/250 për caktimin e Ditës Botërore të Sigurisë së Ushqimit.

## AKP-ja ka nxjerrë në shitje 47 lokale e prona atraktive në disa rajone të Kosovës

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 7 qershor - Agjencia Kosovare e Privatizimit ka nxjerrë në shitje 47 lokale e prona atraktive në disa rajone të Kosovës. “Në valën e fundit të shitjeve të aseteve, e cila është shpallur më 6 qershor dhe do të jetë e hapur deri më 26 qershor, janë tenderuar 47 prona që ofrojnë mundësi të shkëlqyeshme për blerje dhe zhvillim të biznesit tuaj. Vala e re e shitjeve të aseteve me nr. 66 (ShAL 66) përfshin 13 asete në rajonin e Prishtinës, ku ka ndërtesa administrative, lokale, depo e toka, që paraqesin mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e veprimtarive biznesore. Në rajonin e Prishtinës, po ashtu, ka lokale e toka në shitje edhe në komunën e Podujevës dhe të Graçanicës. Në rajonin e Pejës janë në shitje 10 asete, si ndërtesa e lokale, depo si dhe objekte hoteliere (motele), që gjenden në Pejë, Gjakovë, Klinë e Istog. Po në rajonin e Pejës ka në shitje edhe toka bujqësore



që janë të përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe për zhvillimin e biznesit”, ka njoftuar ATK-ja.

Në rajonin e Prizrenit mund të ofertoni për blerje të lokaleve dhe depove. Janë gjithsej 10 lokale në shitje në këtë rajon. Po ashtu, në

këtë rajon në tender ka prona që gjenden në komunën e Dragashit. “Në regjionin e Mitrovicës AKP ka nxjerrë në shitje 12 asete, lokale, zyrë me sipërfaqe të ndryshme atraktive për zhvillim biznesi. Po ashtu, ka asete edhe në komunën e Vushtrrisë. Të gjitha këto asete të

ndërmarrjeve shoqërore paraqesin mundësi të shkëlqyera për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë, kurse në rajonin e Gjilanit janë 2 asete të tenderuara në ShAL 66”, theksohet në njoftim.

AKP-ja ka njoftuar se blerësit

mund të konkurrojnë për njërin nga këto asete apo mund të konkurrojnë për më shumë asete. “Gjithë procesi i dorëzimit të ofertave dhe i hapjes dhe zbulimit të çmimeve është i siguarur dhe garantuar dhe zhvillohet me transparencë të lartë, në prani të medieve dhe të gjithë blerësve konkurrentë dhe transmetohet drejtpërdrejt. Ofertat e mbyllura për njësitë/asetet që janë në shitje përmes Shitjes së Aseteve me Likuidim nr. 66 duhet të dorëzohen në ‘Sallën e konferencave - Hoteli Grand’, në Prishtinë, më 26.06.2024, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull. Kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30. Gjatë kësaj periudhe palët e interesuara e kanë mundësinë të marrin informata më të detajuara si dhe t'i vizitojnë për së afërmi pronat e ofruara për shitje”, ka njoftuar AKP-ja.

## 72 multikultivatorë për fermerët e Gjilanit

GJILAN, 7 QERSHOR - Komuna e Gjilanit ka mbështetur fermerët e këtij qyteti. Në kuadër të kësaj përkrahjeje është bërë edhe shpërndarja e 72 motokultivatorëve. Kjo mbështetje kap shifrën e 90 mijë eurove, ndërsa i pari i komunës ka theksuar se që

nga viti 2023 e deri me këtë projekt janë ndarë mbi 1.5 milion euro në mbështetje të fermerëve.

“72 motokultivatorë me vlerë rreth 90 mijë euro janë ndarë sot për fermerët përfitues”, tha kryetari Alban Hyseni.

Kryetari i kësaj komune,

Alban Hyseni, premtoi se do të vazhdojë mbështetja rekorde e fermerëve. Ndërsa drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bajram Isufi, ka thënë se këto pajisje do të kenë ndikim dhe lehtësim për bujqit në kryerjen e punëve, duke theksuar

kështu se janë të përkushtuar t'i ndihmojnë fermerët dhe se do të vazhdojnë subvencionet e formave të ndryshme. “Ne do të jemi gjithmonë afër fermerëve për t'i përkrahur ata me të gjitha kapacitetet”, ka thënë Bajram Isufi.





# Sekuena filmike që ndryshoi mënyrën se si e shohim luftën

Nga: **Mark ALLISON** / BBC  
(titulli: How Saving Private Ryan's D-Day sequence changed the way we see war)  
Përkthimi (i pjesëshëm)  
Telegraf.com

Në mesin e 156 mijë trupave aleate që zbarkuan në Normandi më 6 qershor 1944, në terren ishin kameramanët e Njesisë së Filmit dhe të Fotografisë të Ushtrisë Britanike/Kanadeze, si dhe të Njesisë Fotografike Amerikane. Një përplazhet e invadimit, ata krijuan një dosje të jashtëzakonshme që shpejt e gjeti rrugën drejt buletinëve të lajmeve në të dy anët e Atlantikut – duke nisur kështu një obsesion kinematografik për Ditën-D, i cili vazhdon për 80 vjet rresht. Nga melodrama romantike e Henry Kosterit [D-Day the Sixth of June, 1956] e deri te aksioni horror me zombi i Julius Averyt [Overlord, 2018], kineastët kanë mbetur të magjepsur nga spektakli dhe drama njerëzore e zbarkimeve në Normandi. Por, asnjë film nuk e ka formësuar si duhet imagjinatën popullore të Ditës-D, sa kryevepra e Steven Spielbergut e vitit 1998 – Shpëtimi i ushtarit Rajan [Saving Private Ryan].

Spielbergu e afroi audiencën më afër se kurrë me pamjet dhe tingujt e tmerrshëm të luftimeve, duke rishpikur filmin e luftës në proces. Skena hapëse e betejës, e cila përshkruan zbarkimet e ShBA-së në plazhin Omaha, është tabloja befasuese dhe krejtësisht tronditëse e luftës si ferr, ndryshe nga çdo gjë që është hasur më parë në kinemanë amerikane. “Në këta 23 minuta, Spielbergu krijoi një moment të historisë së filmit që meriton vendin e vet – krahas hapave të Odesës të [Sergei] Eisensteinit, ndjekjes së karrocave së udhëtarëve të [John] Fordit dhe betejës në shi të samurajëve të [Akira] Kurosawas – në panteonin e sekuencave të shkëlqyera të filmit aksion”, shkruan James Chapman – profesor i studimeve të filmit në Universitetin e Lesterit – në librin e tij Lufta dhe filmi [War and Film].

I xhiruar në bregun lindor të Irlandës me rreth 2 500 rezervistë të Forcave Mbrojtëse Irlandeze, si statistikë, është i palëkundur në përkushtimin ndaj originalitetit. Rampa e varkës bie dhe ushtarët e rinj sakatohen nga plumbat dhe mortajat, para se të mund të arrijnë në plazh. Djemtë e lënduar kërkojnë gjymtyrët që u mungojnë, ndërsa të tjerët bërtasin për nënat teksa zorrët derdhen në rërën e lagur nga gjaku. Kinematografia e Janusz Kamiński qëllimisht kujton



pamjet originale të buletineve të lajmeve dhe fotografitë e Robert Capas, ndërsa kompozitori i muzikës, John Williams, nuk ofron asnjë tingull për kakofoninë e të shtënave të armëve dhe vdekjes. “Shpresojmë se, nëse i kemi bërë gjërat siç duhet, audiencia do të mendojë se ne ishim atje”, thotë Spielberg në dokumentarin për realizimin e filmit [Making Saving Private Ryan].

Menjëherë u pranua rëndësia e tij si moment vendimtar në historinë e kinemasë. Kritika e Janet Maslin, në The New York Times, e shpalli “filmin më të mirë të luftës të kohës sonë”, ndërsa Roger Ebert tha se aksioni ishte “më ilustrues sesa çdo film lufte që kam parë”. Filmi që atëherë u bë pikë referimi për kinemanë moderne të luftës dhe vulë kinematografike mbi Luftën e Dytë Botërore. Hija e tij shtrihet mbi çdo film luftarak të çerekshkullit të fundit, nga Black Hawk Down (2001) i Ridley Scottit deri te All Quiet on the Western Front (2022) i Edward Bergerit.

“Filmi është aq i fuqishëm dhe i realizuar me kaq mjeshtëri, sa që qëndron me ne përgjithmonë si një lloj baze vizuale dhe emocionale për atë që imagjinojmë se çfarë ka qenë plazhi Omaha dhe Normandia. Është aq i saktë sa që përmirëson njohën e historisë. Disa nga incidentet që përshkruan filmi janë marrë drejtpërdrejt nga rrëfimet e të mbijetuarve”, thotë John C. McManus, profesor i historisë ushtarake në Missouri S&T dhe autor i një libri për Normandinë [The Dead and They About to Die: The Big Red One në

Omaha Beach].

Në të vërtetë, pikëpamja subjektive e ofruar nga Spielbergu, qëllimisht e pengon audiencën të kuptojë tablonë më të madhe të Ditës-D. Derisa epikat e mëparshme të Normandisë – si The Longest Day (1962) e Darryl F. Zanuckut – dhanë pamje të gjerë të betejës, duke përfshirë të shtënat gjithëpërfshirëse ajrore dhe sekuencat e gjata nga këndvështrimi gjerman, Spielbergu nuk e bën asnjë përpjekje të tillë për të kontekstualizuar veprimin. Gjithçka në Omaha përjetohet nga këndvështrimi i kufizuar i kapitenit Miller që luhet nga Tom Hanks. Armiqtë e Vermahtit që qëllon në të paraqiten në skica të paqarta, struktur prapa mitralozave të zhurmshëm ose midis fortifikimeve.

Akoma më pak kohë i kushtohet aleatëve të Amerikës në fushatën e Normandisë; përmendja e tyre e vetme është një referencë e shkurtër përçmuese ndaj gjeneralit “të mbivlerësuar” britanik Montgomery. “Shpëtimi i ushtarit Rajan jep përshtypjen se Dita-D ishte çështje tërësisht amerikane”, thotë James Chapman. “Historianët britanikë u munduan të vinin në dukje se në terren, më 6 qershor, kishte më shumë trupa britanike dhe të Komonuelthit sesa amerikanë”.

Pas betejës të dhunshme hapëse, skenari i Robert Rodatit zhvendoset në një territor më konvencional, duke kujtuar filmat klasikë të aventurave, të “burrave në mision” si The Guns of Navarone (1961) ose Where Eagles

Dare (1968). Disa ditë pas pushtimit, kapiteni Miller urdhërohet të mbledh një skuadër dhe të lëviz në kërkim të ushtarit Rajan (Matt Damon), parashutistit të cilit tre vëllezër iu vranë kohët e fundit në luftë [bazohet në historinë e vërtetë të vëllezërve Niland].

Derisa Milleri dhe skuadra e tij fillimisht ankohen për absurditetin e misionit të tyre, duke rrezikuar jetën e tetë vetëve për të shpëtuar një njeri, ata përfundimisht arrijnë të kuptojnë, sipas fjalëve të rreshterit Horvath që luhet nga Tom Sizemore, se “një ditë mund të kthehemi prapa dhe të themi se shpëtimi i ushtarit Rajan ishte e vetmja gjë e mirë që mundëm të nxirnim nga gjithë kjo rrëmujë e tmerrshme dhe e ndyrë”. Rajani është më shumë sesa një individ – ai përfaqëson një mjet me të cilin këta të rinj të brutalizuar mund të kapen pas humanizmit mes tmerreve më çnjerëzore. Funksionon si metaforë për drejtësinë morale të misionit më të gjerë çlirimtar të Amerikës në Luftën e Dytë Botërore, pavarësisht nga sakrificat e tmerrshme që kërkonte.

Kjo nuk do të thotë se filmi është triumfalist. Përkundër patriotizmit, skenari ka qëndrim të paqartë ndaj heroizmit dhe nuk i shmanget pasojave psikologjike të luftës. Duart e kapitenit Miller dridhen në mënyrë të pakontrolluar, ndërsa ai dhe veteranët e ushtrisë nën komandën e tij janë të prirë të qajnë; këto janë shenja të dukshme të lodhjes nga lufta, ose të asaj që tash quhet stresi post-

traumatik. Është shumë larg stoicizmit të John Wayneit te The Longest Day.

Por, derisa Milleri dhe pjesa më e madhe e skuadrës së tij arrijnë të kontrollojnë frikën në kulmin e betejës, rreshteri Upham, i cili luhet nga Jeremy Davies, dështon në këtë provë. Edhe pse është i njohur me poezitë që nxisin luftën, të Tennysonit dhe Emersonit, ai nuk mundet ta mbledhë brenda vetes forcën e tillë. I pamësuar për të luftuar, është i gjymtuar nga frika gjatë betejës kulmore dhe nuk është në gjendje të veprojë në mbrojtje të miqve. Është moment i mundimshëm dhe i pazakontë që një film luftarak i Holivudit të përshkruajë frikakakët. Edhe pse ata që nuk e kanë përjetuar kurrë luftën mund ta përçmojnë Uphamin dhe ta çmojnë guximin dhe gjakftohtësinë e kapitenit Miller nën zjarr, e vërteta është se për të qenë ushtar kjo kërkon instinkte brutale që shumëkush thjesht nuk i posedon.

Ata që kërkojnë rrëfim historik të asaj që ndodhi në Ditën-D, mund të shërbejnë më mirë nga The Longest Day ose nga ndonjë numër i dokumentarëve. Por, Shpëtimi i ushtarit Rajan komunikon përvojën e luftës – ndjesitë fizike, përgjegjësitë dhe plagët mendore – me një ndershmëri të paparë. Ka trimëri, shoqëri dhe sakrificë, por ka edhe frikë, tmerr dhe turp. Në 80-vjetorin e Ditës-D, teksa këto përvoja rrëshqasin nga kujtesa, himni i Spielbergut për të rënë është më kumbues se kurrë. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## U17 dhe U19 e Kosovës mësojnë kundërshtarët për kualifikimet e Evropianit 2025

Në selinë e UEFA-së në Nion të premtën është tërhequr shorti për rrethin e parë kualifikues të Kampionatit Evropian 2025 për grupmoshat 17 dhe 19 vjeç në

konkurrencën e vajzave. Përfaqësuesja e Kosovës U17 është vendosur në Grupin B4 të Ligës B, ku janë përfshirë edhe Izraeli dhe Shqipëria. Ndeshjet e këtij rrethi

kualifikues, në të cilin të përzgjedhurat e Sanije Krasniqit do të garojnë për kalim në Ligën A, do të zhvillohen në Shqipëri, prej 30 tetorit deri më 11 nëntor.

Ndërkaq, Përfaqësuesja e Kosovës U19, e drejtuar nga Albina Rrahmani, do të garojë në Ligën A për kualifikimet e Evropianit 2025. "Dardanet" U19 janë

përfshirë në grup tejet të fortë, me Gjermaninë, Danimarkën dhe Greqinë. Ndeshjet e Grupit A1 do të zhvillohen në Gjermani prej 25 nëntorit deri më 3 dhjetor.

## 'The Athletic': Kujdes nga Shqipëria, në 'Euro 2024' ata mund të jenë 'hirushja'

Tiranë, 7 qershor - Në prag të "Euro 2024", prestigjiozja "The Athletic" është fokusuar në analizimin e çdo kombëtareje pjesëmarrëse në Evropianin e Gjermanisë (14 qershor-14 korrik). Ndër të tjera, i ka kushtuar një hapësirë të veçantë edhe kombëtares së shqiptarëve, për herë të dytë në histori në këtë turne madhor. Kuqezinjtë siguruan kualifikimin pasi e mbyllën të parët me 15 pikë një grup me përfaqësuese të traditës si Polonia dhe Republika Çeke.

### Trajneri

Sylvinho, ish-mbrojtësi i majtë i Arsenalit e Barcelonës, kualifikoi Shqipërinë në Evropian. Braziliiani e mbylli futbollin më 2010, pas një përvoje të shkurtër te Manchester City. Më pas shpenzoi vitet më të mira të dekadës duke marrë përvojën si trajner te Cruzeiro, Sport Recife dhe Nautico në Brazil. Gjithashtu, shërbeu si asistent i Roberto Mançinit tek Interi dhe i Tites në kombëtaren e Brazilit. Si trajner i parë, aventura e tij fillestare ishte me Lyonin më 2019. Nuk shkoi shumë mirë. ai u shkarkua pas 141 ditësh, me skuadrën e pozicionuar në vendin e 14-të pas nëntë ndeshjesh. Pas përvojes franceze, Sylvinho qëndroi nëntë muaj në Brazil, te Corinthiansi, ekip të cilin e udhëhoqi drejt vendit të pestë. Por u shkarkua tri ndeshje pas nisjes së sezonit të ri. Zgjedhja e logjikshme për karrierën e tij më pas ishte Shqipëria. Dhe pikërisht me kuqezinjtë braziliani po përjeton momentin më të mirë. Ai mori drejtimin e kombëtares shqiptare përpara fillimit të eliminatorëve të "Euro 2024" dhe e renditi në vendin e parë. Para Republikës Çeke, Polonisë, Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Ishte hera e parë që Shqipëria

mbylli në vendin e parë një fushatë kualifikuese. Dhe e dyta herë që u kualifikua në Evropian. Rekord i Sylvinhos prej 6 fitoresh në 12 ndeshjet e para e bëjnë trajnerin që i ka bërë nisjen më të mirë një eksperience menaxheriale me Shqipërinë. Për udhëheqjen e Shqipërisë drejt Gjermanisë, Sylvinhos iu dha një nga nderimet më të larta të vendit: Dekorata e Artë e Shqiponjës që ndahet për trimëri në luftë ose për akte të guximit qytetar në kohë paqeje. Ai është i huaji i parë që merr këtë çmim! Dhe që atëherë i është dhënë shtetësia shqiptare. Kështu që ky bashkëpunim mes Shqipërisë dhe Sylvinhos po shkon për mrekulli.

### Jasir Asani

Një sulmues që dështoi të shënonte në 15 paraqitje për Kisvardan në ligën elitare të Hungarisë më 2022, mund të mos ishte emri që të mbushë plot entuziazëm. Apo një emër që pritej të dhuronte spektakël, por Jasir Asani ka kaluar 18 muaj të jashtëzakonshëm! Në fillim të vitit 2023 ai e ndërroi Hungarinë me Korenë e Jugut, duke u bashkuar me Gwangju, ku pati një sezon mjaft të mirë. 7 gola në 30 ndeshje. Pothuajse në të njëjtën kohë, Sylvinho po kërkonte në mbarë globin për një sulmues të djathtë shqiptar, i cili gjuan me këmbën e majtë. Një lojtar që mund të ishte një kërcënim në formacionin e tij 4-3-3. Asani, për herë të parë në Kombëtare në moshën 27-vjeçare, debutoi ndaj Polonisë. Në ndeshjen e parë kualifikuese të Euro 2024, ai i nisi nga minuta e parë të tetë ndeshjet kualifikuese. Dha tri asistime dhe shënoi po kaq gola. Eurogola! Nuk ka dyshim se ai është, gjithashtu, një talent i rrallë



dhe i aftë për momente shkëlqimi. Ekziston një përmbledhje në YouTube për të me titull: "Kur futbolla bëhet art". Po e lejuat të futet në brendësi me të majtën e tij, mbrojtja juaj do të ketë probleme...

### Pikat e forta

Një mbrojtje e fortë që pësoi vetëm katër gola në kualifikuese, e udhëhequr nga kapiteni i Atalantës, fitues i Ligës së Evropës, Berat Gjimeshi. Ka disa lojtarë me bazë italiane në skuadër, duke përfshirë mbrojtësin e djathtë të Lazios, Elseid Hysajn. Mesfushorin qendror të Interit, Kristjan Asllanin, dhe Nedim Bajramin e Sassuolos, i cili ka për detyrë të jetë lidhja midis mesfushës dhe sulmit. Ata kanë, gjithashtu, portierë të mirë. Sylvinho ka një vendim për të marrë mes portierit të Brentfordit, Thomas Strakoshës, dhe 35-vjeçarit të Empolit, Etrit Berishës. Trajneri ka ndarë paraqitjet e tyre në mënyrë të barabartë; gjashtë për Strakoshën, po kaq për Berishën. Shqipëria ka edhe mungesën e pritshmërisë, veçanërisht pasi u shortua në një grup "ferri" së bashku me Italinë, Spanjën dhe Kroacinë. Askush nuk pret asgjë dhe, le të jemi të sinqertë, Shqipëria cilësohet nga Italia, Spanja dhe Kroacia si "ndeshja që duhet ta

fitojmë patjetër". Me këtë vjen një mentalitet "underdog", që të jep më tepër shtysë për ta shkaktuar surprizën. Dhe Shqipëria mund ta realizojë nëpërmjet disa prej lojtarëve të vet, padyshim të talentuar. Ata u morën katër pikë çekëve në kualifikuese (përfshirë një fitore të madhe 3-0 në shtëpi) dhe mundën Poloninë 2-0 po në Tiranë. Nënvlërësojini shqiptarët dhe do të jeni në rrezik...

### Pikat e dobëta

Golat janë një çështje. Shqipëria shënoi vetëm 12 gola në eliminatorë, dy më pak se shifra më e ulët e realizuar nga një fitues i grupit (Turqia). Sylvinho ka qenë krejtësisht i pamëshirshëm në vendimin e tij për listën. Nuk u përfshi sulmuesi i Konyasporit, Sokol Cikalleshi, golashënuesi i tretë më i mirë i Shqipërisë i të gjitha kohëve. Me 13 realizime. Ai nisi si titullar shtatë nga tetë ndeshjet kualifikuese. Teksa deklaroi tërheqjen nga Kombëtarja një ditë pas shpalljes së listës. Gjithashtu u la jashtë Myrto Uzuni, autor i 11 golave për Granadën e rënë nga La Liga në sezonin që lamë pas. Në vend të kësaj, barra e shënimit do të bie mbi sulmuesin e Chelseat, Armando Brojën. 23-vjeçari dha sinjalin e

duhur në miqësoren ndaj Lihtenshtejnit teksa hapi serinë e golave me finalizimin e minutës së 31-të. Rey Manaj nuk luajti në kualifikuese, por sulmuesi, i cili ka luajtur me Interin, Barcelonën dhe Watfordin, ishte golashënuesi i tretë më i mirë në Superligën turke sezonin e kaluar. 18 gola me Sivassporin.

### Fakt interesant

Brazilianë dhe argjentinas te Shqipëria. Fituesi i Premierë Ligës me Manchester Cityn, Pablo Zabaleta, është ndihmësi i Sylvinhos. Edhe ish-mesfushori i Middlesbrough, Doriva, është gjithashtu në stafin teknik. Sylvinho nuk është lojtari i parë i profilit të lartë që merr drejtimin e Shqipërisë. Vitet e fundit, ata, gjithashtu, i besuan ish-mbrojtësit të Milanit, Real Madridit dhe Romës, Christian Panucit. Si edhe ish-mesfushorit të Ajaxit dhe Holandës, Arie Haan.

### Pritshmëritë në shtëpi

Shqipëria renditet e 66-ta në botë, e dyta më e ulëta në turne. Vetëm përpara Gjeorgjisë, kështu që tifozët dinë të kenë pritshmëri të ulëta. Por ata shpresojnë dhe ëndërrojnë për diçka të veçantë. Çdo fitore do të ishte dita më e madhe në historinë e futbollit shqiptar. Sylvinho është e kuptueshme që po mundohet ta ulë euforinë. Duke pasur parasysh kundërshtarët në grup. Dhe gjasat minimale për të avancuar në fazën me eliminim. "Nën presion? Jo, fare", ta pret shkurt. Më pas vijon: "Kundërshtarët tanë nuk luajnë për ta kaluar grupin, por për ta fituar trofeun. Ne shkojmë për ta treguar besimin tonë te njëri-tjetri. Dhe zemrën e shpirtin e ekipit. Kjo është ajo që ne duhet të shfaqim".

## Sot fillon FIBA 3x3 Europe Cup

Për herë të parë në Kosovë do të organizohet FIBA 3x3 Europe Cup. Kjo ngjarje e rëndësishme për basketbollin 3x3 do të mbahet në Sheshin

"Skënderbeu" në Prishtinë më 8 dhe 9 qershor. Gara do të ketë nga mëngjesi i së shtunës deri në mbrëmje, përkatësisht nga ora 9:30 të mëngjesit deri në

orën 22:30, derisa të dielën zhvillohen ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finale. Finalet do të zhvillohen nga ora 18:40 e femrave dhe

19:05 e meshkujve. Kosova do të paraqitet në këtë event dhe konkurrencat në këtë event dhe synon paraqitje sa më të mira. Vashat e Kosovës janë në grup

me Qipron, Andorrën dhe Irlandën. Ndërkohë, "Dardanët" do të ndeshen me Azerbajxhanin, Qipron, Shqipërinë dhe Armeninë.



## Prishtina 01 fiton finalen e parë ndaj Liqenit

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Skuadra e Prishtinës 01 ka shënuar fitore në ndeshjen e parë të finales së "play-off" -it të Lirimi Superligës në futsal. Në ndeshjen e zhvilluar në palestrën "1 Tetori" në kryeqytet, në një atmosferë madhështore, Prishtina 01 ka

arritur ta mposhtë skuadrën e Liqenit të Drenasit, pas vazhdimeve, me rezultat 3:2. Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e Azem Ibrahimit. Shifrat i barazoi Arif Limani në pjesën e dytë. Në vazhdime prishtinasit u treguan më efikas. Shefki

Kamberi realizoi për 2:1. Ky gol bëri që Liqeni të lëshohet me të gjitha forcat në sulm, gjë të cilën e ndëshkuan prishtinasit me golin e tretë përmes Drilon Maxharrajt, që çoi shifrat në 3:1. Skuadra nga Drenasi nuk u dorëzua dhe arriti që përmes Steven Abril ta ngushtojë

epërsinë në 3:2. Megjithatë, koha e mbetur në dispozicion nuk i mjaftoi për ta gjetur golin e barazimit dhe për ta siguruar edhe një periudhë të lojës shtesë. Ndeshja e dytë e finales së "play-off" -it zhvillohet më 10 qershor në Drenas.



## Reali përfiton mbi 140 milionë euro nga triumfi në Ligën e Kampionëve

MADRID, 7 QERSHOR - Reali i Madridit vazhdon t'i marrë faqet e para të medieve botërore edhe pas suksesit në Ligën e Kampionëve. Pasi shtoi edhe më tej palmaresin e tij ndërkombëtar, duke e çuar në 15 numrin e Ligave të Kampionëve në histori, tani është koha që klubi spanjoll t'i korrë edhe fitimet ekonomike nga UEFA. Sipas asaj që raporton katalanasja "Mundo Deportivo", presidenti Florentino Perez shumë shpejt do të shohë t'i shtojë në arkat e klubit jo pak, por plot 141 milionë e 520 mijë euro. Kësaj shifre do t'i shtohen pak muaj më vonë edhe 3.5 milionë euro, si pjesëmarrës i finales së Superkupës së Evropës (kundër Atalantës, fituesja e Ligës së Evropës), plus 1 milion tjetër në rast se arin ta fitojë atë. Gjithsesi, duke mbetur tek arkëtimet e sezonit marramendës dhe pa asnjë humbje (rekord historik për "Galaktikët", njësoj si Barcelona e sezonit 2008-2009) shifrat thonë: 15 milionë e 640 mijë euro, premio e pjesëmarrjes në



edicionin e sapombyllur, ndërkohë që menjëherë me to Reali i Madridit ka përfituar nga UEFA edhe 36.38 milionë euro nga renditja historike në kompeticionin më të rëndësishëm për klube. Ndërkohë, fakti që arriti ta mbyllë edhe fazën e grupeve me 6 fitore, ku secila dhuron 2.8 milionë euro, përfitimi nga ky triumf absolut garanoi edhe 16.8 milionë euro të tjera. Kualifikimi në 1/8-at e turneut i solli 9.6 milionë, kalimi në çerekfinale 10.6, në gjysmëfinale 12.5 milionë dhe ngritja e trofeut edhe 20 milionë

euro të tjera. Në të njëjtën kohë, 20 milionë euro janë bonusi i "marketpool"-it të UEFA-s që e dërgon shifrat totale në 141.52 milionë euro. Dhe të mendosh që këtu mungojnë fitimet e vet klubit nga shitja e biletave të "Santiago Bernabeut", fitimet nga dyqanet e markës "Real Madrid", apo edhe gjithçka tjetër ofron impianti i rekordmenëve të Evropës, të cilat mund t'i dërgojnë shifrat e fitimeve të "Los Blancos", vetëm nga aventura në Ligën e Kampionëve, në nivele stratosferike.

## Bostoni shkatërroi Dallasin në finalen e parë

BOSTON, 7 QERSHOR - Boston Celtics ka mundur me rezultat të thellë 107:89 Dallas Mavericksin në ndeshjen e parë të serisë së finaleve të NBA-s. Skuadra vendase kaloi në epërsi 37:20 pas çerekut të parë dhe ndeshja ishte e njëanshme që në fillim. Në një moment, Bostoni kishte një epërsi prej 29 pikësh dhe megjithëse Dallas shkurti rezultatin në 72:64 në mesin e çerekut të tretë, pësoi një disfatë bindëse. Bostoni u udhëhoq drejt fitores nga Jaylen Brown me 22 pikë, Kristaps Porzingis i cili u rikthye pas një dëmtimi prej një muaji, me 20 pikë dhe Jayson Tatum me 16 asistime. Dallas nuk



u ndihmua as nga i madhi Luka Donçiqi me 30 pikë e 10 kërcime dhe Kyrie Irvingu dështoi me vetëm 12 pikë. Vëmendje të madhe në tribuna tërhoqi edhe trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, i cili u shfaq në TD Garden dhe

brohoriste për Celticsin, për të cilin kishte veshur edhe xhupin e tyre. Ndeshja e radhës e serisë finale luhet natën mes të dielës dhe të hënës, sërisht në Boston. Celticsi ka ndjekur titullin e parë që nga viti 2008 dhe një titull i ri i mundshëm do të ishte i 18-ti në histori, gjë që do ta bënte përsëri rekordmen, duke marrë parasysh se aktualisht është i barabartë me Los Angeles Lakers me nga 17 tituj secili. Nga ana tjetër, Mavericksi, udhëhequr nga sloveni i madh Luka Donçiq, është në kërkim të titullit të dytë të NBA-së në historinë e tij, pasi Dirk Nowitzki i udhëhoqi ata në të parin në vitin 2011.

### SHKURT

#### Milani kërkon sulmues, Broja në planin B

AC Milan është duke tentuar transferimin e sulmuesit Joshua Zirkzze, raporton "Sky Sport". Nëse Milani nuk arrin transferimin e sulmuesit në fjalë, plani B është transferimi i sulmuesit shqiptar Armando Broja. Përveç Brojës, një alternativë tjetër mbetet edhe sulmuesi ukrainas i Gironës, Artem Dovbyk. Rol të rëndësishëm do të luajë edhe paraqitja e Brojës në "Euro 2024". Në rast se sulmuesi shqiptar arrin të lë gjurmë në Evropian, gjasat janë të mëdha që Broja të hedhë një hap të rëndësishëm edhe në karrierën e tij sa iu përket klubeve.

#### Bufon: Italia mund të jetë protagoniste në 'Euro 2024'

"Euro 2024" është gati për të startuar. Italia edhe këtë evropian mbetet sërisht një prej kandidatëve për të shkuar deri në fund, pavarësisht se këtë herë lista e futbollistëve të thirrur nga Spaletti nuk "tremb". Ndërkohë interesimit të gazetarëve për objektivat e "Azzurrëve" këtë evropian, i është përgjigjur edhe legjenda e portës Gigi Buffon. "Mbërrijmë në këtë evropian në gjendje të mirë, pas një pune të bërë gjatë kësaj jave në aspektin fizik. Do të shkojmë në 'Euro 2024' me besimin e plotë se mund të jemi protagonistë. Kemi ambicien për të shkuar deri në fund të kompeticionit", ka thënë Buffoni, i cili më pas foli edhe për Napolin e Antonio Contes: "Nëse Napoli nuk do të bëjë mirë sezonin e ardhshëm, do të përfundojë minimalisht në vend të dytë".

#### Maguire: Jam i shkatërruar, por do ta mbështes Anglinë

Harry Maguire do të humbasë "Euro 2024", i cili vuan nga një dëmtim në pulpë, e pësuar në maj dhe nuk ka arritur të rikuperohej në kohë për eventin e madh të futbollit. Në një postim në llogarinë e tij në "Instagram", mbrojtësi shprehu keqardhjen që nuk ishte i aftë fizikisht ta ndihmonte ekipin në "Euro 2024". "Jam i shkatërruar që nuk jam përzgjedhur për të luajtur për Anglinë në Evropianin e kësaj vere. Pavarësisht nga përpjekjet e mia më të mira, nuk arrita të kapërcejja një dëmtim të pulpës. Ndoshta u përpoqa shumë për të arritur aty. Jam thjesht i shkatërruar", ka thënë Maguire. Mbrojtësi theksoi rëndësinë që ka skuadra për të por, siguroi, pavarësisht prej trishtimit, se do ta mbështesë ekipin anglez gjatë garës. "Për mua, ta përfaqësosh Anglinë është nderi më i madh. Do të thotë gjithçka për mua. Nëse nuk mund ta ndihmoj skuadrën si lojtar, do ta mbështes si tifoz, së bashku me pjesën tjetër të vendit. Shkoni atje dhe fitoni, djemal!", ka shtuar Maguire.

## Legjendat e Gjermanisë: Mund ta fitojmë Kampionatin Evropian

Gjermania do të jetë mikpritëse e Kampionatit Evropian që do të nisë nga 14 qershori deri më 14 korrik 2024 me 24 ekipe kombëtare. Para fillimit të Kampionatit, legjendat e Bundesligës kanë dhënë opinionet e tyre lidhur me paraqitjen e

Gjermanisë në këtë kampionat. Hansi Muller, legjenda e mesfushës së VfB Stuttgart dhe kampion evropian në vitin 1980, ka thënë se Gjermania ka shanse për ta fituar këtë kampionat. "Kemi një cilësi të madhe. Jam i bindur se do të kemi një

kampionat evropian të jashtëzakonshëm dhe kemi shanse të mëdha për ta fituar titullin", është shprehur Muller. Derisa ish-portieri i Bayernit, Raimond Aumann (kampion bote 1990), beson se për Gjermaninë gjysmëfinalja është e garantuar.

"Kam besim të madh te ekipi. Ne do të arrijmë në gjysmëfinale, pastaj sigurisht që ju duhet fat", është shprehur ai. Kurse ish-futbollisti i Bremenit, Uli Borowka, thotë se gjysmëfinalja edhe duhet të jetë synim i kombëtares gjermane. "Qëllimi në

kampionatin evropian në shtëpi duhet të jetë patjetër gjysmëfinalja. Skuadra ka potencial. Dhe nga gjysmëfinalët e tutje, gjithçka është e mundur", ka thënë Borowka. Për gjermanët kjo është pjesëmarrja e 14-të radhazi në Kampionatin Evropian të UEFA-s.





### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 08.06.2024 të shpall:

#### KONKURS

**Dy (2) Vozitës të kategorisë "C"**- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 428.56 € Bruto

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtinë të tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësen e Punës në të cilën evidencën punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjetet, dhe të njëjtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjetet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësen e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjetet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjetlje të pandërgjegjësme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtëpërdrejtë;
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Është i obliguar që në cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejtë nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

#### Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.

#### Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 08.06.2024 deri me 22.06.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 08.06.2024 të shpall:

#### KONKURS

**Një (1) Inkasant-** Njësia në Skenderaj, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 350.00 € Bruto

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bënë zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë.

#### Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.

#### Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 08.06.2024 deri me 22.06.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 08.06.2024 të shpall:

#### KONKURS

**Roje-** Njësia në Skenderaj, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme apo filllore

Lartësia e pagës mujore: 331.00 € Bruto

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë-objekteve dhe mjeteve themelore të Ndërmarrjes përkatësisht NP.
- Bënë shikimin e rregullt të objekteve dhe lokacionit në të cilin është i caktuar sipas orarit mujor.
- Në rast të shpërthimit të zjarrit, ndërmer masat për shuarjen dhe lajmërimin e tij.
- Përcjell gjendjen dhe ndalon çasjen e personave të panjohur në lokacionet ku nuk lejohet sjellja e personave të panjohur.
- Mban evidencën në librin e rojës për ndrrimin e tij.
- Evidenton dhe kontrollon hyrjen dhe daljen e automjeteve dhe personave në oborrin e Ndërmarrjes.
- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë dhe kryen punë tjera sipas nevojave të paraqitura në lokacionin e deponisë së mbeturinave sipas kërkesës dhe urdhërit nga udhëheqësi i drejtëpërdrejtë si dhe kryen edhe punë tjera të kësaj lëmie.

#### Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.

#### Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 08.06.2024 deri me 22.06.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adil Islamaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizren.

Behar Stoliqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizren.

Bisa Velickovic shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

Slavica Velickovic shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim në Z.K. Llabjan respektivisht Z.K. Ramun, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2024 në ora 10:00 në shkollën SHFMU "Haxhi Zeka" në Zahaq Komuna Pejës, do të organizohet debat publik nga Kompania "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ; passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, për fabrikën për prodhimin e artikujve të plastikës për paketim në Z.K. Llabjan respektivisht Z.K. Ramun, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për riciklimin e artikujve të plastikës në Z.K. Llabjan, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2024 në ora 10:30 në shkollën SHFMU "Haxhi Zeka" në Zahaq Komuna Pejës, do të organizohet debat publik nga Kompania "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ; passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "EGI Group" Sh.p.k Zahaq, Pejë, për fabrikën për riciklimin e artikujve të plastikës në Z.K. Llabjan, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.







# TRADITË QË NGA

# 1992

